



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 28

Tiranë – E martë, 21 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9997, datë 6.2.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1971
Dekret i Presidentit nr. 10003, datë 10.2.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1971
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 31, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Lezhë, z. Rrok Rroku, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1971
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, z. Zija Mema, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1973
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 33, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Shkodër, z. Muharrem Shkjau, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1975
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 34, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, z. Robert Dajani, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1977



DEKRET
Nr. 9997, datë 6.2.2017
PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Serkan Tevfik Şentürk
2. Ernest Gjokë Culaj
3. Miranda Xhevdet Popaj
4. Ibrahim Xhelil Duraj
5. Gafurr Çamil Likaj
6. Suzan Abedin Salihu (Vila)
7. Rejhane Ali Salihu
8. Kushtrim Ali Salihu
9. Naim Idriz Halilaj
10. Naim Hisen (Hysen) Dula
11. Savaş Ihsan Karaca
12. Clement Hunte
13. Alla Andrej Chernobrovkina (Çjernobrovkina)
14. Albana Sutki Muja (Mema)
15. Tringa Engjel Çollaku
16. Vera Deda Lleshi
17. Hakan Kenan Akin
18. Adel Rizk Abdel-Hamid (Abdelhamid) Elsayed (Elsayed Khalil)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 10003, datë 10.2.2017
PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për

shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrit të Kulturës dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Faton Rexhë Shoshi
2. Cristiano Damião Cardoso Da Silva
3. Denis Fehmi Avdiu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 31, datë 7.2.2017

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE
NË FORMULARIN E
VETËDEKLARIMIT TË FUNKSIONARIT
PUBLIK, ANËTAR NË KËSHILLIN E
BASHKISË LEZHË, Z. RROK RROKU,
NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015
“PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Lezhë, z. Rrok Rroku, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 14, neni 15, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiakë, nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.

Referuar neneve 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, KQZ-ja thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Rrok Rroku, ku dha shpjegimet për faktet dhe rrethanat e çështjes.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3,

germa “b” e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartpërmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Rrok Rroku, në cilësinë e anëtarit të këshillit të Bashkisë Lezhë, rezultoi se z. Rrok Rroku është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 6 (gjashtë) muaj burg, për kryerjen e veprave penale, “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal, vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me gjobë 50 000 mijë lekë, për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal, vendimi nr. 139, datë 14.10.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Referuar germës “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi... brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, të Kodit Penal.

Vepra penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 30/1,6 dhe 59 i Kodit Penal, përfshihen, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 138/2015.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar



.....

2. Për personat që parashikohen nga shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar datës 17.7.2015, së vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër në bazë të të cilit është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” dhe nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, z. Rrok Rroku për këtë veprë penale është brenda periudhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. Rrok Rroku, në lidhje me veprën penale , “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, bazuar në germën “b”, pika 2, neni 2, të ligjit nr. 138/2015, funksionari publik është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1, e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit..., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d” shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Rrok Rroku.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 14, nenin 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreun V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Lezhë, z. Rrok Lin Rroku.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrin.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

KRYETAR
Denar Biba

VENDIM

Nr. 32, datë 7.2.2017

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË FUNKSIONARIT PUBLIK, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË RROGOZHINË, Z. ZIJA MEMA, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, z. Zija Mema, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 14, neni 15, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiakë, nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.

Referuar neneve 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, KQZ-ja thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Zija Mema, ku dha shpjegimet për faktet dhe rrethanat e çështjes.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa “b”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartpërmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Zija Mema, në cilësinë e anëtarit të këshillit të Bashkisë Rrogoshinë, rezultoi se është dënuar për veprën penale neni 248 “Shpërdorim Detyre” me vendimin nr. 116, datë 23.11.2009, nga Gjykata e Kavajës.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultoi se z. Zija Mema “Në bazë të vendimit nr. 116, datë 23.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është deklaruar fajtor për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe në bazë të nenit 248 të Kodit Penal e dënon me 8 muaj burgim dhe 400.000 lekë gjobë.

Referuar germës “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave, të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi... brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, të Kodit Penal.

Vepra penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 30/1,6 dhe 59 i Kodit Penal, përfshihen, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 138/2015.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.



Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

2. Për personat që parashikohen nga shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar vendimit nr. 116, datë 23.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të formës së prerë në bazë të të cilit është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” dhe nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, z. Mema për këtë veprë penale është brenda periudhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. Zija Mema, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 30/1,6 dhe 59 Kodit Penal bazuar në germën “b”, pika 2, neni 2, të ligjit nr. 138/2015, funksionari publik, z. Zija Mema është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1 e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit..., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d”, shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Zija Mema.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i

ndryshuar; nenin 14, nenin 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreun V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Elbasan, z. Zija Hekuran Mema.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

KRYETAR
Denar Biba

VENDIM

Nr. 33, datë 7.2.2017

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË FUNKSIONARIT PUBLIK, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, Z. MUHARREM SHKJAU, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Shkodër, z.



Muharrem Shkjau, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 15, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiakë, nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.

Drejtoria e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, sektori i dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. 2700, datë 20.6.2016 i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të z. Muharrem Shkjau.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa “b”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartpërmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në Formularin e vetëdeklarimit të z. Muharrem Shkjau, në cilësinë e anëtarit të këshillit të Bashkisë Shkodër, rezultoi se është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 200.000 (dyqind) mijë lekë gjobë, vendimi nr. 14, datë 18.10.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për kryerjen e veprave penale, “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 2 (dy) vjet burg, vendimi nr. 271, datë 5.7.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për kryerjen e veprave penale “Mbajtje të municionit luftarake”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, “Vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal.

Referuar germës “c”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave, të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi... kur janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....



3. Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Vepra penale “Mbajtje të municionit luftarake”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, “Vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal, klasifikuar si krim, për të cilën funksionari publik është dënuar me 2 (dy) vjet burg, referuar të dhënave në vërtetimin e gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Drejtoria e Burgjeve nuk kanë kaluar 10 vjet.

Pika 4 e nenit 4 të ligjit nr. 138/2015, parashikon se për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar nga z. Muharrem Shkjau, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprat penale të “Mbajtje të municionit luftarake”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal, “Vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, bazuar në germën “c”, pika 1, neni 2, të ligjit nr. 138/2015, funksionari publik, z. Muharrem Shkjau është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1, e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për mos kandidim dhe moszgjidhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe mos kandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit..., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Në këto kushte, KQZ-ja duhet të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Muharrem Shkjau.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Shkodër, z. Muharrem Rustem Shkjau.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

KRYETAR
Denar Biba

VENDIM

Nr. 34, datë 7.2.2017

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE
NË FORMULARIN E
VETËDEKLARIMIT TË FUNKSIONARIT
PUBLIK, ANËTAR NË KËSHILLIN E
BASHKISË MALËSI E MADHE, Z.
ROBERT DAJANI, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN
E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare



Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, z. Robert Dajani, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 14, neni 15, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e

Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiakë, nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.

Referuar neneve 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, KQZ-ja thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Robert Dajani, ku dha shpjegimet për faktet dhe rrethanat e çështjes.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa “b”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartpërmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Robert Dajani, në cilësinë e anëtarit të këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe, rezulton se është dënuar (2) dy vjet e (6) gjashtë muaj burgim për veprën penale neni 283/2 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se z. Robert Dajani “Në bazë të vendimit nr. 124, datë 27.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal e dënon me (2) dy vjet e (6) gjashtë muaj burgim.

Referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave, të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88, paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278, paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal.



Vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283, i Kodit Penal, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 138/2015.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

1. Për personat që parashikohen nga shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.

Referuar llojit të veprës penale neni 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” për të cilin me vendim është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Shkodër dhe në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, z. Dajani për këtë veprë penale është brenda periudhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar nga z. Robert Dajani, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 Kodi Penal, bazuar në germën “a”, pika 1, neni 2, të ligjit nr. 138/2015, funksionari publik, z. Robert Dajani është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit..., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d”, shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Robert Dajani.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 14, nenin 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe, z. Robert Pashko Dajani.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

**KRYETAR
Denar Biba**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë